



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1349 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 201, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Konceptin dhe Metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike, në kuadër të **projektit të GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)** në KM 196+540 – KM 196+350, Petovë.-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin dhe Metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike, në kuadër të **projektit të GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)** në KM 196+540 – KM 196+350, Petovë, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të kryhen sondazhet arkeologjike, duke lidhur më parë akt-marrëveshje tre palëshe, ndërmjet investitorit me shoqërinë e licencuar në arkeologji e cila do të kryejë këto sondazhe, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i sondazheve arkeologjike të paraqitet në KKA.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO BURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al